

2 KKP për degën e pastrimit 3% më shumë pagë për Zvicrën gjermane

3 Nisma parlamentare «Varfëria nuk është krim» Të luftohet varfëria, jo të varfrit

4 Shtrenjtimi i sigurimit shëndetësor 2023 Të shfrytëzohen mundësitë e kursimit tek premitë

Nr. 6 | Tetor 2022 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Konferenca e Grupeve të Interesit: Pa migrant:e s'ka demokraci

Fuqizimi i të drejtave politike tani!



Grupet e Interesit të Unia përmes këtij aksioni kërkojnë të drejta qytetare e politike edhe për migrantët!

Zgjerimi i të drejtave qytetare, pjesëmarrja e njerëzve në demokraci, pavarësisht pasaportës, lufta kundër diskriminimit: Këto ishin temat e konferencës së Grupeve të Interesit të Unia, të shtunën e 24 shtatorit. Në një rezolutë rreth 100 pjesëmarrës kërkojnë fuqizimin e të drejtave politike.

Marie Saulnier Bloch dhe Hilmi Gashi

Ne e dimë shumë mirë, që migrantet e migrantët në sigurimet shoqërore paguajnë më shumë kontribute se sa marrin. Ne e dimë, që migrantet e migrantët janë ndër më të meritoret për sukseset ekonomike, kulturore, sociale e shoqërore, përjashtoj vendimmarrjen politike. Në këtë pikë, ata janë shumë të kufizuar. Dhe ligjet që kanë të bëjnë me këtë çështje janë restriktiv në rritje. Migrantët për shkak të shkeljeve të vogla mund të dëbohen. Edhe leja e përhershme e qëndrimit C po degradohet, nëse dikush në nevojë merr ndihmë sociale. Kur votohet mbi ligjet, fjala bie ligjin e punës, sigurimet shoqërore, ligji penal, mbrojtja klimatike etj., ata nuk pyeten dhe nuk mund të bashkëvendosin, edhe pse këto ligje i prekin ata dhe kanë ndikim në jetën e tyre.

Shembulli më i ri është ai në ditën e zhvillimit të konferencës. Edhe pse rritja e moshës së pensionimit për gra-

të i prek të gjithë njerëzit në vend, një e katërta e popullatës së Zvicrës pa pasaportë zvicerane nuk kanë të drejtë të thonë as Po e as Jo. Ashtu sikur gratë para 51 viteve. Ato nuk kishin të drejtë as të votonin as të zgjidhnin.

Kufizimi i të drejtave të migrantëve e dëmton demokracinë. Shtu kësaj se: kush ka një shtetësi të huaj, jeton mesatarisht me pagë e pension dukshëm më të ulët. Kjo situatë është e paprueshme, ishte mesazhi i fuqishëm dhe solidar i Grupeve të Interesit të Unia: e migrantëve, rinisë, grave dhe pensionistëve, të cilët për herë të parë aprovuan një rezolutë të përbashkët.

Impulse mobilizuese, qëndrime të qarta dhe një rezolutë e fuqishme

Kryetarja jonë Vania Alleva në referatin e saj hyrës tregoi qartas, se sa i rëndësishëm është përfaqësimi i anëtarëve tanë pa pasaportë zvicerane – të cilët

janë shumicë në të gjithë sektorët – në sindikatën tonë. Tek fushata kundër AHV/AVS21 ne ishim vetëm pak vota larg suksesit: çka do të kishte ndodhur, sikur në të vërtetë të gjithë të prekurit, të gjithë banorët do të votonin? Referentë të ndryshëm ndriçuan tema si diskriminimi i shumëfishtë, natyralizimi dhe migracioni si motor i barazisë. Më pas u zhvilluan edhe diskutime të thelluara nëpër punëtorë.

Rezoluta për barazi

Pas diskutimeve nëpër punëtorë dhe në plenum, pjesëmarrësit aprovuan një rezolutë, e cila kërkon hapa konkret drejtë barazisë:

- E drejta në natyralizim për gjeneratat e lindura në Zvicër
- E drejta e natyralizimit pas 4 viteve qëndrim, pa pengesa burokratike dhe financiare

- E drejta e votës dhe zgjedhjes në rrafshin komunal e kantonal për të gjithë banorët

Të drejtat qytetare nuk duhet të jenë privilegj

Pjesëmarrja në vendimet politike është një e drejtë themelore, e cila më në fund duhet të njihet dhe lejohet. E drejta qytetare është një e drejtë, jo privilegj. Sindikata Unia është organizata më e madhe e migrantëve në Zvicër dhe angazhohet për mundësi të barabarta, të drejta pjesëmarrëse, dhe siguri qëndrimi të anëtarëve të saj pa pasaportë zvicerane – në rrafshin politik, në botën e punës dhe në shoqëri. Ne mund të krenohemi, që Grupet e Interesit të Unia, marrë parasysh politikën dominuese konservatore e të djathtë borgjeze në rritje, ka aprovuar një rezolutë, e cila kërkon barazi në vend të politikës fajësuese. Vetëm të bashkuar ne jemi më të fortë!

Editorial



Të dashura kolege e kolegë

Tani më është bërë e njohur: premitë e arkave shëndetësore rriten mesatarisht për 6.6%. Edhe tek faturat e energjisë elektrike priten rritje masive çmimesh. Gjë që mund të qojë në rritje të tjera çmimesh. Inflacioni ka arritur 3.5%. Shumë – para së gjithash punëmarrës me paga të ulëta – janë të shqetësuar dhe merakosur, se si do ti përballojnë më tej harxhimet. Nevojiten masa për të zbutur koston në rritje dhe pagat duhet urgjentisht të përshtaten!

Shumë mendojnë, nëse paratë nuk mjaftojnë, në rastin më të keq së paku mund të kërkojnë ndihmë sociale. Kjo qëndron, mirëpo vetëm pjesërisht: personat pa pasaportë zvicerane në rrethana të caktuara rrezikojnë të humbasin lejen e tyre të qëndrimit, nëse janë të varur nga ndihma sociale. Kjo detyron shumë migrantë të bëhen raste borxhlinjsh. Pasi që kanë frikë se do të humbasin lejen, andaj edhe, në vend se të lajmërohen tek enti social, detyrohen të marrin hua nga të njohurit, apo kredi nga institute të dyshimta financiare. Edhe këtu duhet të gjendej një zgjidhje: Varfëria nuk është krim!

Pastaj votimet e 25.9.2022: 50,6% kanë votuar për rritjen e moshës së daljes në pension për gratë, dhe kështu në kurriz të grave kanë pranuar reformën e AHV/AVS. Rezultati ishte shumë i afërt: Zvicra perëndimore, Tiçino, shumica e grave kanë thënë qartas «Jo». Nuk ka mjaftuar, mirëpo obligon që tek revizimi i fondit pensional profesional që pritet, për të mbajtur fjalën e djathtë borgjeze, për të gjetur dhe për të përpunuar një zgjidhje e mirë për pensionet e ulëta të grave, punonjësve me kohë të pjesshme si dhe punonjësve me të ardhura të ulëta.

Lufta për paga dhe pensione më të mira vazhdon!

Montaña Martín

News

Novartis procedurat e konsultimit donë ti kryejë vetëm si një ushtrim alibi

Novartis në vitin 2021 ka trefishuar fitimin e pastër në 24 miliarda franga. Një pjesë e fitimit të rritur shpjegohet nga një blerje aksionesh nga Roche. Edhe pa këtë fitim shtesë korporata shënon fitime miliardash. Novartis dëshiron të shlyejë 1400 vende pune në Zvicër, për të rritur diferencën e fitimit. Megjithatë, siç ka paralajmëruar sivjet, donë të kursejë edhe 1.5 miliarda franga në kurriz të punonjësve të vet. Korporata donë që të imponojë këtë përmes shkrirjes të farmacisë dhe onkologjisë në një. Gjithandaj nëpër botë korporata donë të likuodojë 8000 vende pune. Sindikatat kërkojnë një procedurë të vërtetë konsultimi për zhvillimin e alternativave tek reduktimi i vendeve të punës.

Pagat minimale në gastronomi rriten deri në 188 franga

Pagat minimale në gastronomi për vitin 2023 janë bërë të njohura. Unia ka arritur që të barasvlerësojë pagën minimale plotësisht me inflacionin, gjë që është shumë me rëndësi duke pasur parasysh shtrenjtimin. Përpos kësaj pagat minimale realisht do të rriten për 40 franga. Pagat e reja minimale hyjnë në fuqi më 1 janar 2023 dhe vlejën për të gjithë Zvicrën (përjashtuar pagat minimale më të larta të vlefshme kantonale). Kështu gastronomia dërgon një sinjal të rëndësishëm duke pasur parasysh shtrenjtimin jashtëzakonisht të lartë. Pikërisht në sektorët me paga të nivelit të ulët është vendimtare, që shtrenjtimi të barasvlerësohet tërësisht, për të mos vuajtur në fund muajit të punësuarit nga shkurtime pagash.

Te ndalet eksodi infermier – masa të menjëhershme tani!

Para rreth një viti popullata zvicerane me shumicë absolute ka aprovuar iniciativën infermiere, pasi që dëshironin të siguronin një përkujdesje e infermieri të mirë. Përkundër aprovimit, më shumë se 300 punonjës infermiere për çdo muaj largohen nga ky profesion. Derisa federata e kantonet ia hedhin përgjegjësinë njëra tjetrës, kriza në fushën e përkujdesjes shëndetësore është duke u ashpërsuar: Në përkujdesjen afatgjatë nevojta për përkujdesje të moshuarve dhe përkujdesjes afatgjatë deri më 2040 parashihet të rritet për 56%. Për të siguruar këtë përkujdesje nevojitet përputhshëm më shumë personel. Nëpër spitale gjithashtu situata është shumë e pasigurt: vende të hapura pune dhe shtretër të mbyllur janë bërë përditshmëri. Përmes një aksioni infermierët dëshironin tu jepnin shtyrje shtesë kërkesave të tyre. Politika duhet që të ndërmerre masa për të ndal largimin nga profesioni, kërkojnë sindikatat. Aksioni i infermierëve me 26 nëntor, në ora 14:30 në sheshin federal të Bernës. Lajmërimi: <https://www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/dienstleistungsberufe/pflege-betreuung/anmeldung-pflegeaktion>

BHI paraqet planin strategjik për 5 vitet e ardhshme

Nga 4 deri më 7 tetor 2022 në Madrid të Spanjës u zhvillua kongresi i 5-të i BHI (sindikata ndërkombëtare e ndërtimit dhe drurit). Me këtë rast, pos tjerash, u prezantua edhe plani 5 vjeçar strategjik i sindikatës globale. Planin i cili bazohet në parimin «askush nuk duhet të lihet mbrapa» («no one should be left behind»), është i ankoruar në 5 fusha pune të BHI-së, gjegjësisht: 1) Lufta për drejtësi klimatike; 2) Zgjerimi i strukturave sindikaliste; 3) Garantimi i punëmarrësve të sigurtë dhe të shëndoshë; 4) Globalizimi i të drejtave të punëmarrësve dhe 5) Ardhmëri të drejtë të punës.



Vjeshtë e nxehtë sindikaliste

Pagat e vjeshtës dhe mobilizimi në ndërtimtari

Vjeshta në kuptimin politik sindikalist do të jetë e nxehtë: në sektor të ndryshëm janë duke u zhvilluar negociata për rritje pagash. Në ndërtimtari është duke u zhvilluar mobilizimi për ripërtëritjen e KKP për më shumë mbrojtje të punëtorëve të ndërtimtarisë.

Hilmi Gashi

Shtrenjtimi aktualisht është tek 3,5%. Pas çmimeve të energjisë edhe premitë e sigurimeve shëndetësore janë rritur së tepërmi. Rritja e kostos ngarkon posaçërisht punëmarrësit me paga të ulëta. Shumica prej tyre nuk kanë mundësi financiare dhe janë në dilemë se si të përballen e ti mbulojnë kostot. Situata ekonomike për ndërmarrjet edhe më tej është shumë e mirë, andaj edhe rritja reale e pagave është e mundshme dhe e nevojshme. Sindikatat për këtë arsye kërkojnë rritje të përgjithshme të pagave prej 4 deri në 5%, jo vetëm për të balancuar inflacionin, porse në fakt për të rritur pagat për të gjithë.

«Të gatshëm për të luftuar deri në fund!»

Kontrata Kombëtare e Punës për ndërtimtarinë kryesore (KKP) është njëra ndër Kontratat më të rëndësishme të Punës në Zvicër dhe rregullon kushtet e punës dhe pagat e 80000 punëtorëve të ndërtimtarisë. Edhe pas 5 deri 7 rundeve të bisedimeve të planifikuara, pajtueshmëria duket të jetë shumë e largët. Ndërtimtaria ka vite që është duke lulëzuar, presioni është duke u rritur dhe punëtorët e ndërtimtarisë tanë më në fund kërkojnë më shumë

mbrojtje për shëndetin, dhënie fund mospagimit të kohës së udhëtimit dhe një rritje pagash korrekte për të gjithë. Por çka duan sipërmarrësit e ndërtimit? Të kundërtën. Ata kërkojnë orare pune të paplanifikuara dhe punë me thirrje, ditë edhe më të gjate pune si dhe përkeqësime tjera.

Punëtorët e ndërtimtarisë luftojnë për të drejtat e tyre dhe kundër pikëpamjeve radikale të sipërmarrësve të ndërtimit. Në një intervistë me «20 Minuten» punëtori i i ndërtimtarisë Xhafer Sejdiu markon një vijë të qartë: «Ne jemi të gatshëm të luftojmë deri në fund!».

Deri më tani Shoqata e Sipërmarrësve të Ndërtimit është treguar e pa kompromis. Aktualisht është duke u zhvilluar një votim mbi grevën nëpër kantiere të ndërtimit në gjithë Zvicrën. Janë planifikuar ditët e para të protestës. Pasi, nëse sipërmarrësit e ndërtimit nuk duan të dëgjojnë sinjalet e deritashme, atëherë do tu përkujtohet atyre se kush në të vërtetë e ndërton Zvicrën.



Pamje e njëres nga demonstratat e punëtorëve të ndërtimtarisë dhe Unia për KKP me paga e kushte me të mira pune

Vlerësimi i pastrimit

3% më shumë pagë në pastrim

Gjithçka është duke u shtrenjtuar. Tek blerja, tek pagesa e korrentit, tek karburantet, ka disa muaj që ne ndjejmë shtrenjtimin. Pos kësaj edhe premitë e arkave shëndetësore për vitin 2023 janë shtrenjtuar edhe më shumë. Andaj është i nevojshëm rregullimi i inflacionit. Konkretisht kjo domethënë rritje pagash.

Emine Sariasslan

Unia ka negociuar për vitin 2023 një barasvlerësi inflacioni prej 3% për degën e pastrimit në Zvicrën gjermane. Me këtë mënjanohet, që zhvillimet pozitive të pagave e tri viteve të fundit të jenë viktimë e inflacionit. Me kohë është arritur marrëveshja që pagat në vitet e ardhshme në çdo dy vite të rriten për 2%. Kështu punëmarrësit e pastrimit për vitet 2022 deri 2024 marrin gjithsej 7% më shumë pagë.

Pa pastrim nuk bënë

Mbi 90 000 persona punojnë në pastrimin e objekteve – 80% nga të cilët me punë të pjesshme. Shumica e të punësuarve janë gra dhe kanë një sfond migracioni. Puna në pastrim nënvlerësohet. Ajo është e rëndë fizikisht, presioni kohor është i lartë dhe varësisht nga hapësira e punës nevojiten aftësi e njohuri të shumta paraprake. Pastrimi i një spitali dallon shumë nga pastrimi i një kompleksi zyresh. Pikërisht kriza e koronës ka treguar, sa e pazëvendësueshme është puna e pastrimit për të gjithë shoqërinë.

Pastrimi duhet të vlerësohet meritueshëm

Përkritazi me pagën ne kemi disa të arritura. Kontratat e Përgjithshme të Punës (KKP)

definojnë kushtet e punës të të punësuarve. Që nga fuqizimi i KKP për pastrim në vitin 2004 për Zvicrën gjermane, pagat janë rritur për 35%. Megjithatë: Puna në pastrim duhet të vlerësohet më tej dhe më shumë. Ne i falënderojmë të gjithë punonjësit e pastrimit, për punë e tyre të çmuar.

Kontrata e Përgjithshme e Punës

Aktualisht kemi tri Kontrata Kolektive të Punës për pastrimin e objekteve, të cilat janë me detyrim të përgjithshëm. Me

detyrim të përgjithshëm domethënë, që ndërmarrjet pastruese i nënshtrohen KKP, edhe nëse ato nuk janë anëtare të Shoqatës së punëdhënësve «Allpura». Në praktikë kjo domethënë, që KKP ndikon sikur një ligj. Për KKP neve na nevojiten sindikata të forta. Një sindikatë është e fuqishme, nëse ka shumë anëtarë dhe ketë anëtarë organizohen me sindikatën e tyre Unia. Ne e përsërisim edhe njëherë: Së bashku jemi të fortë!



Puna në degën e pastrimit është prore e rënde dhe e vështirë

Aprovimi i AHV/AVS 21 & Iniciativa e Bankës Kombëtare (SNB)

Rritje pensionesh të AHV/AVS dhe arrije barazisë në paga

Parashtesa e AHV/AVS në votimet e 25 shtatorit është aprovuar me një diferencë të vogël prej 50,6% të votave për, gjithashtu është aprovuar rritja e ndërlidhur me te, me 55,1% vota për, të tatimit në vlerën e shtuar.

Osman Osmani

Debati dhe konfrontimi mbi sistemin pensional në Zvicër mbetet edhe më tej një nga sfidat më të mëdha shoqërore. Revidimi i AHV/AVS ishte vetëm njëri nga hapat e parë. Pas kësaj do të pasojë një reformë e sigurimit pensional profesional. Barazia mes burrave dhe grave gjithashtu mbetet njëra nga sfidat e mëdha. Rritja e moshë së pensionimit është një fyerje për shumë gra. Edhe pse ato edhe më tej kanë paga dhe pensione tejet të ulëta nga burrat, tani iu duhet të punojnë edhe një vit më gjatë. Unia kërkon që tani më në fund të jetësohet barazia në paga. Pas kësaj duhet të rriten edhe pensionet e ulëta të AHV/AVS.

Çka ndodh pas aprovimit të AHV/AVS 21?

Ndryshimet, mbi të cilat është votuar me 25 shtator 2022, është planifikuar të hyjnë në fuqi me 1 janar 2024. Deri atëherë vlen edhe më tej e drejta e tanishme, ndër të tjera edhe pensionimi i grave me 64 vjet.

Fitimet me miliarda të Bankës Kombëtare për fuqizimin e pensioneve

Banka Kombëtare e Zvicrës (SNB) është duke grumbulluar miliarda fitime. Këto para duket ti kthehen popullatës. Iniciativa e SNB e sindikatave dëshiron që një pjesë e fitimeve të shkojë në fondin e pensioneve të AHV/AVS. Me këtë ne forcojmë sigurimin më të rëndësishëm shoqëror dhe shmangim reduktimin e pensioneve.



Pensionet janë viktimë e normave negative të interesit

Politika e normave negative të interesit të Bankës Kombëtare të Zvicrës (SNB) ka vu nën presion masiv arkat e pensionit. Pensionet janë ra në mënyrë dramatike. Për shumikënd paratë nuk mjaftojnë për të jetuar. Prandaj, fondet e pensionit të AHV/AVS duhet të forcohet me të ardhurat nga kamatat negative dhe fitimet e SNB-së. Nga kjo përfitojnë të gjithë.

Qeveria federale dhe Parlamenti duan të rrisin shpejtë moshën e pensionimit dhe të ulin pensionet. Në vend të kursimit shkatërrues të AHV/AVS, përmes nismës së SNB mund të forcojmë financimin e

AHV/AVS – dhe të ndalojmë parashtresat reduktuese.

Rishpërndarja e drejtë e miliardave

Nuk është në rregull, që SNB fitimet e saja me miliarda ti grumbullojë në kasafortën e saj në Börsenstrasse në Cyrih. Shpërndarja e fitimeve të SNB-së për AHV-në forcon sigurimin e pleqërisë pa i ngarkuar kuletat e punëmarrësve. Është me rëndësi të theksohet se pjesa e mëparshme e kantoneve në fitimet e SNB-së mbetet e garantuar.

Ju lutemi të nënshkruani iniciativën e SNB: <https://snb-initiative.ch/>

Iniciativa parlamentare «Varfëria nuk është krim»

Të luftojmë varfërinë, jo të varfrit!

Me 21 shtator shumica e parlamentit nacional është shprehur për aprovimin e iniciativës parlamentare «Varfëria nuk është krim» të deputetes Samira Marti. Iniciativa donë të përmirëson situatën juridike të migrantëve, të cilët janë të prekur nga varfëria.

Marília Mendes

Varfëria mund të prek të gjithë. Në situatë emergjente kushtetuta zvicerane garanton të drejtën në mbështetje. Por, nëse migrantët duan të përdorin këtë të drejtë dhe kërkojnë ndihmë sociale, mund të humbasin të drejtën e tyre të qëndrimit.

Një rast

Sikur tregon rasti i «Sofisë», i dokumentuar nga Qendra vrojtuese për azil dhe të drejtën e të huajve (SBAA). «Sofia» udhëtoi me 1984 nga një shtet i BE/EFTA për në Zvicër. Ajo morri lejen e përkohshme të qëndrimit, më vonë edhe atë përhershme. Ajo për shumë vite me radhë ishte në marrëdhënie pune, deri kur për shkak të sëmundjes morri një pension invaliditeti. Kur asaj më pas iu refuzua e drejta e sigurimit të invaliditetit, nuk i mbete gjë tjetër, porse të marrë ndihmë sociale. Për këtë arsye enti i migracionit e kërcënoi me ndërmarrjen e masave bazuar në ligjin për të huajt.

Iniciativa parlamentare dhe aleanca

Përmes iniciativës parlamentare njerëzit si «Sofia» nuk do të duhej të kishin edhe më tej frikë. Iniciativa parasheh që migrantët, të cilët janë për më shumë se 10 vite në Zvicër, të mos humbin lejen e tyre të qëndrimit shkaku i ndihmës sociale, përveç rasteve kur ata kanë keqpërdorë me dashje marrjen e ndihmës sociale. Për mbështetjen e iniciativës kanë apeluar PS, Unia dhe SBAA duke krijuar një aleancë me emër të njëjtë (www.poverty-is-not-a-crime.ch). Rreth 80 organizata, ndër të cilat edhe prointegra.ch i janë bashkangjitur aleancës dhe deri më tani 17 000 persona kanë nënshkruar letrën e hapur drejtuar parlamentit.

Si do të shkojë puna më tej?

Pas vendimit të parlamentit nacional edhe senati do të shprehet mbi iniciativën. Nëse gjithashtu edhe senati e aprovon, njerëzit e

prekur nga varfëria, të cilët janë të varur nga mbështetja financiare, mund të lirohen nga frika prej pasojave nga ligji për të huajt.



Nëse nuk e keni bërë deri më tani, nënshkruajeni letrën e hapur (<https://poverty-is-not-a-crime.ch/de/>) dhe bëjeni atë të njohur, duke postuar këto materiale:

- Postimi në Facebook me video apel nga Samira Marti
- Postimi në Facebook (frëngjisht): <https://bit.ly/3e5wfy5>
- Postimi në Instagram (gjermanisht): <https://bit.ly/3RJwRH8>
- Postimi në Instagram (frëngjisht): <https://bit.ly/3SI18NV>

Intervista



E drejta për zbatim të drejtë të ligjeve

Krahas këshillimit në të drejtën e punës dhe të sigurimeve shoqërore, Unia mbështetë anëtarët e saj edhe tek problemet që kanë të bëjnë me të drejtën e migracionit. Kjo është shumë me rëndësi për shumë anëtarë. Edhe në Valis, ku ka probleme të shpeshta me zyrtarët për migracion. Horizonte bisedoi mbi këtë çështje me sekretaren e Unia, Angéla Tavares.

Angéla, me cilat pyetje të drejtohen anëtarët migrantë?

Shumë migrante e migrantë kanë nevojë për mbështetjen tonë, pasi që ndihen të pafuqishëm karshi autoriteteve. Komunitat janë vendet e para të kontaktit të tyre, sa i përket çështjeve të migracionit. Në vend se të ndihmojnë, ato më shumë krijojnë vështirësi. Kështu, fjala bie, shtetasit e BE-së për të kërkuar leje qëndrimi, sipas marrëveshjes për lëvizje të lirë të personave, do mjaftonte të tregojnë vetëm një dokument identifikimi dhe kontratën e punës. Kjo, për një kohë të gjatë ka funksionuar kështu. Rishtas, enti i migracionit në Valis kërkon një dëftesë të ndihmës sociale, të regjistrit penal dhe të zyrës përmbarese. Kjo nuk është në përputhje me Marrëveshjen mbi lëvizjen e lirë mes BE-së dhe Zvicrës. Mirëpo, njerëzit kanë drojë të këmbëngulin në të drejtat e tyre. Ne shkojmë me ta në komunë, ose i thërrasim entet në telefon. Unia angazhohet që të drejtat e tyre të respektohen.

A janë këto rastet e vetme, që ju i keni?

Jo, fare jo. Një problem i përsëritshëm janë vështirësitë me rastin e bashkimit familjar. Enti i migracionit merr vazhdimisht vendime të gabuara. Edhe pse kemi fituar një grumbull rastesh, ata nuk mësojnë nga kjo. Po ashtu edhe problematika e lejeve L. Në Ober-Valis kemi shumë traste të njerëzve, që ka 10, 15 vite që marrin lejen L. Këta punëmarrës me dëshirë do të kishin një marrëdhënie qiraje të sigurte, të blinin një automobil, etj., me fjalë tjera një jetë normale. Mirëpo, me lejen L integrimi në jetën «normale» është i vështirësuar.

Në shtator qasja tek enti i migracionit ka qenë i kufizuar. Përse?

Raste të tepërta të papërfunduara. Ka vite që ne vrojtojmë, se si migrantët presin me muaj të tërë të marrin përgjigje në kërkesat e tyre për leje. Shpesh ndodh, që të jepet leja L, kur ajo ka skaduar. Por atë megjithatë duhet paguar. Kjo të prekurve u krijon shumë vështirësi, për shembull, nëse marrin një banesë me qira, apo nëse duan të hapin një xhironlogari bankare. Zyrtarët nuk arrijnë të kryejnë punën me dhënie e lejeve. Unë megjithatë isha e befapsuar pozitivisht. Si duket problemet janë bërë të njohura dhe janë ndërmarrë masa. Se a do të ndryshojë diçka, nuk është ende e sigurt. Anëtarët njoftojnë, që janë duke prituri ende lejet e tyre.

Për çka ka kaq shumë pritje?

Procedurat tani janë shumë më të komplikuar se sa përpara. Nëse kërkohen shumë dokumentacione, dosje të kthyer, gjoja se janë të pakompletuara, etj., atëherë gjithçka do të çalojë. Shpesh mungon edhe baza ligjore për një procedurë të tillë: gjithmonë merren vendime, të cilat janë në kundërshtim me praktikën juridike. Migrantët duhet të ndërmarrin veprime dhe të humbin kohë të panevojshme, por edhe zyrtarët gjithashtu. Unia kërkon, që ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatohen drejtë – për të garantuar të drejtat e migrantëve. Migrantët dëshirojnë të kenë të bëjnë me zyrtarë që ata i trajtojnë njerëzisht – dhe kjo do të ishte baza e çdo shërbimi publik.

Çfarë këshillash i jep ti të prekurve?

Nëse ata kanë ndjenjë, që diçka nuk është në rregull, duhet të na kontaktojnë neve. Ne mund të ndihmojmë drejtpërdrejtë apo tu themi, se ku mund të marrin ndihmë e mbështetje. Nganjëherë mjafton vetëm një thirrje e jona telefonike, për ç' bllokuar situatën. Është me rëndësi, që migrantët të informohen mbi të drejtat e tyre. Dha pastaj, shumë me rëndësi: të mos injorohet ndonjë shpresë apo formë tjetër e komunikimit zyrtar. Është i domosdoshëm, respektimi i afateve. Pa këtë nuk mund të ngulet këmbë në të drejtën ligjore.

Marília Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Aksidenti në punë: A duhet unë ti paguajë vet dëmet?

Unë kam punuar për shumë vite si shofer për një ndërmarrje transportuese. Para 12 vitesh unë kam shkakuar një aksident. Shefi im asokohe ma ka komunikuar me shkrim, që unë duhet të marrë përsipër një pjesë të dëmit, posa të caktohet lartësia e dëmit. Tani më ka larguar nga puna. Gjatë afatit të dorëheqjes më është dhënë paga normale. Para disa ditësh kam marrë një shkresë, me të cilën më është kërkuar që të marrë përsipër 1500 franga të dëmit të shkakuar nga aksidenti. A duhet që unë ti paguajë ato?

Regula Dick: Jo. Sipas praktikës juridike të Gjykatës federale punëdhënësi duhet që më së largu tek paga e fundit të bëjë llogarinë e dëmit dhe ta ndërmarrë atë tek paga, apo së paku që te ndërmerr një rezervë shlyerjeje. Nëse ai nuk e bënë këtë, mund të supozohet në bazë të besnikërisë dhe mirëbesimit, që punëdhënësi ka hequr dorë nga kërkesa e tij.

(Work, 2.9.22)

Puna e re: çka lejohet tek të rinjtë?

Djali im 14 vjeçar donë të blejë një konsolë të shtrenjtë loje. Parat për këtë ai donë që ti kursejë vet. Këtë ai donë ta arrijë duke shpërndarë gazeta me biçikletë çdo mëngjes para se të shkojë në shkollë. Mua më vjen mirë, që ai i ka vu vetit një qëllim dhe që donë të grumbullojë përvojat e para të punës. Mirëpo, unë nuk jam i sigurt, se a lejohet kjo për moshën që ai ka. Si është e rregulluar kjo çështje?



RRITJA E PARAVE TË GJEPIT: Kositja e barit dhe të ngjashme janë të përshtatshëm për këtë qëllim. (FOTO: IMAGO)

Regula Dick: Në rastin e djalit tuaj zbatohet ligji që parasheh rregullat për të rinjtë. Sipas ligjit të punës në parim të rinjtë nën moshën 15 vjeç nuk lejohet të punësohen. Në të vërtetë ka edhe përjashtime: Nga mosha 13 vjeç të rinjtë u lejohet të kryejnë punë të lehta: Këtu hyjnë kryerje të punëve të vogla dhe gjatë pushimeve apo edhe punë shëgertësh. Këto nuk guxojnë të dëmtojnë shëndetin e të rinjtë, të cenojnë sigurinë e tyre ose të kufizojnë zhvillimin personal apo shkollor të tyre. Gjatë kohës së shkollimit lejohet më së shumti të punohet 3 orë në ditë dhe 9 orë në javë. Gjatë pushimeve shkollore lejohet të punohet më së shumti 8 orë në ditë dhe 40 orë në javë përgjatë gjysmës së kohës sa zgjatim pushimet shkollore. Është e lejuar puna për të rinjtë vetëm gjatë orës 6 dhe orës 18.

Bazuar në vlerësimin tim, sa i përket punës që biri juaj donë të obligohet gjatë kohës së shkollimit, është shumë e qartë se nuk është fjala për punë të lehtë. Sasia dhe shpeshtësia janë të larta. Duhet pasur drojë, që atij nuk do ti mbetet kohë e mjaftueshme për të marrë veten dhe do të rrezikohet zhvillimi i tij personal dhe shkollor. Eventualisht do të tejkalohet edhe koha e lejuar javore e punës. Andaj, biri juaj duhet të interesohet për një punë tjetër anësore. Të përshtatshme janë, fjala bie, kositja e barit, përkujdesja e fëmijëve të vegjël dhe gjithashtu edhe bartja e gazetave para së gjithash të shtunave paradite.

(Work, 2.9.22)

Lehonia: A mund të reduktojë punën?

Pas lindjes të fëmijës tim të parë, unë kam reduktuar punën time nga 100 në 80%. Tani jam bërë nënë për së dyti dhe kam lutur eproren time për të zbritur punësimin tim në 60%. Mirëpo, ajo tani ma ka komunikuar, se për shkaqe organizative kjo nuk është e mundur. Mua më duhet që pas pushimit të lehonisë të punoi në volumin e kontraktuar të deritashëm. Nëse unë nuk jam e gatshme për diçka të tillë, marrëdhënie e punës – duke iu përmbajtur afateve të dorëheqjes – do të anulohet. A i lejohet punëdhënësit tim të më largojë nga puna, nëse unë pas pushimit të lehonisë nuk dua të shkoj të punojë 80%?

Marina Wyss: Po. Nuk ekziston e drejta e uljes së volumit të punësimit. Nëse punësimi duhet të përcaktohet ndryshe, nga ajo se si është përcaktuar në kontratë, bëhet fjalë për ndryshim kontrate. Kjo domethënë, që të dyja palët duhet të janë të pajtimit me ndryshimin. Në rastin e juaj, çka është e vërteta, vlejën rregulla tjera përkritazi me mbrojtjen e largimit nga puna shkaku i lehonisë. Kjo domethënë: Nuk lejohet që t'ju largojnë nga puna mes fillimit të shtatzënisë deri në javën e 16 pas lindjes së fëmijës suaj. Nëse megjithatë ndodh kjo, largimi konsiderohet i pavlefshëm dhe i pa ndikim. Me këtë rast kemi të bëjmë me mbrojtjen kohore të largimit nga puna. Kjo domethënë, që punëdhënësi juaj juve në kohën e tanishme nuk guxon t'ju largojë nga puna.

Në përgjithësi unë këshilloj tek largimi në ndërlidhje me shtatzëni dhe lehoninë, të shfrytëzoni të drejtën e këshillimit juridik të Unia, pasi tek një largim i tillë mund të kemi të bëjmë me largim keqpërdorues. Në rastin tuaj nuk shoh ndonjë pikë të qëndrueshme të largimit keqpërdorues: si u tha në fillim, ju nuk keni të drejtë juridike sa i përket reduktimit të volumit të punës.

(Work, 16.9.22)

Rritja e premive të arkave shëndetësore 2023

Kursimi në premitë – tani gjithësesi!

Sipas regjionit dhe arkë së shëndetësisë ju pak a shumë do të jeni të prekur nga rritja e premive për vitin 2023. Në secilin rast gjithësesi do të ketë shtrenjtim, Përveçse, ju shfrytëzoni mundësitë kursyese.

Martin Jakob, *Workzeitung*, 30 shtator 2022 (e përshtatur)

Si mund ta dijë unë, se sa do të rriten premitë në arkën time shëndetësore?

Arka e tanishme e juaj shëndetësore më së largu deri në fund të tetorit duhet t'ju informojë mbi premitë tuaja për vitin 2023. Krahasoni preminë tuaj me arkat tjera përmes www.priminfo.ch. Me këtë llogaritës mund të krahasoni premitë e arkave që veprojnë në regjionin tuaj për vitin vijues për të gjithë anëtarët e familjes.

Si mundem unë pavarësisht arkës së përgjedhur shëndetësor të kursej tek premia?

Duke përzgjedhur modelet kursyese. Kështu ju mund të kurseni mes 10 deri 20%. Në këmbim ju nuk do të jeni të lirë të përzgjidhni mjekun tuaj. Në modelin e mjekut shtëpiak ju obligoheni, që me rastin e secilës herë që sëmureni së pari të konsultoni mjekun tuaj shtëpiak, i cili varësisht nga rasti ju udhëzon më tej tek mjeku specialist. Njëjtë funksionon edhe modeli HMO: tek ky model çdo trajtim i ri fillon me vizitën në kolektivin mjekësor. Ndërsa në «Telmed» (modelin telefonik) kontakti i parë zhvillohet përmes një linje telefonike mjekësore. Mirëpo, në të gjitha modelet, në rast të emergjencës mund të drejtoheni në trajtim menjëhershëm, dhe në rast të kontrolleve paraprake të kujdesit gjinekologjik dhe vizitës tek mjeku i syve, jeni të liruar nga detyrimi konsultues.

A duhet ta rrisë franshizën, për ta ulur më tej preminë?

Nëse jeni i ri dhe i shëndetshëm, kjo është një mundësi. Rriteni franshizën tuaj (mbulimin tuaj vjetor të kostos) nga shuma minimale ligjore prej 300 frangave deri në shumën maksimale prej 2500 frangave, kështu premia juaj vjetore është për rreth 1500 frangave më e ulët. Mirëpo harxhimet tuaja zbriten në këtë shumë, vetëm nëse nuk keni nevojë për trajtim mjekësor! Ju keni mundësinë që për çdo vit për secilin anëtar të familjes suaj të vendosni, sa e lartë duhet të jetë franshiza për vitin e ardhshëm.

A ia vlen ndërrimi arkës shëndetësore, nëse unë kam lirim-kompensim të premisë?

Po. Pasi shumën, të cilën ju përfiton, është pavarësisht prej premisë, të cilën ju në mënyrë efektive e paguani. Pra, sa më e lirë arka shëndetësore, të cilën ju e përzgjidhni, aq më e ulët është shumën, të cilën ju vet duhet ta paguani.

A janë arkat e shtrenjta gjithashtu më të mirat?

Jo në lidhje me përfitimet e siguruar. Pasi në sigurimin e detyruar themelor përkruhet qartas katalogu i përfitimëve dhe se cilat trajtime dhe medikamente duhet të merren përsipër nga arka.

Nëse unë dua të ndërroj arkën shëndetësore, a duhet unë që ti nënshtrohem një kontrolli të mjekësor të mirëbesimit?

Jo. Secila arkë shëndetësore duhet t'ju pranoi pa kushte në sigurimin e obligueshëm themelor shëndetësor. Gjithashtu edhe përkundër problemeve ekzistuese shëndetësore ju mund të ndërroni për çdo vit arkën shëndetësore. Ndryshe qëndron puna sa i përket sigurimit shtesë (shih kornizën).

Si dhe në cilat afate unë mund të ndërroj arkën, franshizën dhe modelin trajtues?

Nëse doni të kaloni në arkën tjetër, duhet që ta jepni dorëheqje me shkresë rekomandë nga kontrata me arkën ekzistuese. Dërgojeni shkresën për çdo rast më së largu me 20 nëntor. (formularin për këtë çështje: rebrand.ly/kkkuendigen). Lajmërohuni njëkohësisht tek arka e re (formulari: rebrand.ly/kkanmeldung).

Nëse doni të qëndroni teka arka e tanishme, mirëpo doni të zbrisni franshizën tuaj, duhet që këtë t'ia komunikoni arkës shëndetësore më së largu deri më 30 nëntor. Për ta ngritur atë, megjithatë keni kohë deri më 31 dhjetor. Ndryshimi i modelit me përzgjedhje të kufizuar të mjekut është gjithmonë i mundur.



Kujdes tek ndërrimi i sigurimit shtesë

Sigurimet shtesë nuk i nënshtrohen ligjit për sigurimet shëndetësore (KVG/LAMal), porse i nënshtrohet të drejtës private. Ja çfarë duhet të dini ju:

- Ju mund të keni një sigurim tjetër themelor nga ai shtesë tek një arkë tjetër. Mirëpo, kjo nuk është mjaft praktike.
- Shihni afatet e dorëheqjes në policën tuaj.
- Kërkoni ofertat dhe krahasoni ato në mënyrë kritike.
- Kujdes tek dorëheqja nga arka e deritashme: Pasi nëse keni pasur një aksident apo sëmundje të gjatë, mund të ndodh që arka e re t'ju refuzoj. Arka e juaj e deritashme nuk është e detyruar t'ju pranojë përsëri, nëse keni dhënë dorëheqje. Në rastet më të mërra, mbeteni pa sigurimin e dëshiruar shtesë. Më shumë rreth kësaj teme: rebrand.ly/zusatzversicherung.